

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Letonia: Rusia po shton sulmet hibride në Europë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/letonia-rusia-po-shton-sulmet-hibride-ne-europe/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 00:17:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	3 shtator 2026, 12:24:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5a8e095aed5b56998af551e4d6c5977dfd9ac7ae748b1782e83bd386b206db62
TEKSTI	00222fbb858571ced12dd4a94cea6d0b26cf0d69976f988614a0485279409579
PAMJA	b1214363d0c7691960292aa6a531c288816792b0587e855372493e5711946683

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	11f9a39be86213be2a4fbc2f90b702f5d6088b34765224b30ef245d9b525b388
E MËPARSHMJA	39bfcf3d238e062096214e046278c69d0a6357aed18edfb1bbafbddd964da445
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/11f9a39be86213be2a4fbc2f90b702f5d6088b34765224b30ef245d9b525b388>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Letonia është një nga vendet që ka përjetuar drejtpërdrejt këto kërcënime. Gjatë muajve të fundit, dronë, disa prej tyre të pajisur me eksploziv, kanë hyrë në territorin e vendit. Ditët e fundit, autoritetet u kanë kërkuar banorëve të qëndrojnë në ambiente të mbyllura pasi avionë ushtarakë rusë kanë shkelur hapësirën ajrore.

Sipas Bražes, objektivi i Rusisë është të dëmtojë ndjenjën e sigurisë në vendet europiane dhe të tregojë se mund të kryejë veprime të papritura dhe të rrezikshme në çdo moment.

“Duam të minojmë ndjenjën e sigurisë në vendet europiane. Rusia kërkon të tregojë se mund të bëjë diçka të papritur, shqetësuese dhe të rrezikshme në çdo kohë dhe në çdo vend”, tha ajo.

Ministrja letoneze tha se sulmet hibride synojnë gjithashtu të përçajin shoqëritë europiane dhe të dobësojnë mbështetjen për Ukrainën. Sipas saj, Rusia po teston gjithashtu se deri ku mund të shkojë me provokimet pa shkaktuar një reagim të drejtpërdrejtë nga vendet europiane.

Braže tha se NATO dhe vendet anëtare mund të marrin masa për të parandaluar këto kërcënime. Ajo përmendi rritjen e pranisë ushtarake në Detin Baltik, ku janë shtuar forcat detare për të mbrojtur kabllot nënujore nga dëmtimet dhe sabotimet.

“Ne kemi rritur ndjeshëm pranimë e forcave detare në Detin Baltik për të parandaluar dëmtimin apo shkatërrimin e kablllove nënujore. Kjo ka ndihmuar, sepse këto incidente nuk po ndodhin më”, tha ajo.

5 Viti i ri shkollor nis edhe në Burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Përballë sulmeve hibride brenda vendeve europiane, ministrja kërkon gjithashtu kufizimin e pranisë ruse. Ajo tha se duhet të kontrollohet numri i personelit diplomatik dhe i punonjësve të ambasadave dhe konsullatave ruse.

Sipas saj, sa më pak persona të dërguar nga Moska të ketë në territorin europian, aq më e kufizuar është aftësia e Rusisë për të vepruar pa u vënë re. Braže përmendi edhe Gjermaninë, e cila ka mbyllur "Shtëpinë e Rusisë" në Berlin, si një nga masat e marra për të reduktuar praninë ruse.

Ministrja tha se Rusia po përpiqet gjithashtu të rekrutojë persona nga vende të treta për të kryer akte të vogla sabotimi. Ajo përmendi raste si djegia e një pajisjeje elektrike të hekurudhave, vjedhja e një flamuri ukrainas apo shkrimet në mure.

"Së pari nisin me veprime të vogla dhe më pas kalojnë në veprime gjithnjë e më të rrezikshme", tha Braže.

Në nivel europian, ajo kërkoj që të reduktohet numri i vizave që u jepen qytetarëve rusë. Sipas saj, vendet e BE-së duhet të diskutojnë më seriozisht kufizimin e vizave turistike, veçanërisht për familjarët e ushtarakëve rusë ose për shtetasit rusë që kanë luftuar në Ukrainë. Braže pranoi se qeveria italiane ka pasur rezerva për këtë propozim, por tha se lejimi i hyrjes në Europë i personave që mund të përbëjnë rrezik për sigurinë duhet të shihet si një çështje serioze.

Ajo foli edhe për situatën financiare të Ukrainës dhe nevojën për të siguruar më shumë fonde për mbrojtjen e vendit. Braže tha se Letonia do të mbështeste çdo propozim të ri të Komisionit Europian për përdorimin e rezervave ruse të ngrira.

Sipas saj, disa banka qendrore europiane kanë vlerësuar se rreziku që Rusia të fitojë një proces në gjykatat ndërkombëtare është shumë i ulët. Ajo kërkoj që diskutimi të mos kufizohet vetëm te rezervat ruse të bllokuara në Belgjikë, por të përfshijë edhe fondet e ngrira në vende të tjera europiane.



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

[Të gjithë artikujt](#)


| Vazhdo të lexosh



BOTA

**Huthët
përshkallëzojnë...**

Xhuljana
Zhuleku 36 minuta
më parë



BOTA

**Zelensky: SHBA
kërquan ndërprerje t...**

Xhuljana
Zhuleku Sot
00:21



BOTA

**Pezeshkian: SHBA
synon kolapsin socia...**

Xhuljana
Zhuleku Dje
23:55



[Lajme](#)

[Programe](#)

[Rrjeti](#)

[Ligjore](#)



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.